



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Numër: 112-01/25

Data: 07.04.2025

Bujanoc

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar nr. 112-01/25, datë 07.04.2025, shpallim:

THIRRJE PËR NDIHMË TË NJËHERSHME FINANCIARE PËR NXËNËSIT PA ASNJË PRIND OSE VETËM ME NJË PRIND (PRINDI/ËRIT I/E TË CILIT/ËVE KANË VDEKUR OSE JANË TË ZHDUKUR)

Ftohen të gjithë nxënësit shqiptarë që bëjnë pjesë në kategorinë e mëposhtme të aplikojnë për ndihmë të njëjshme financiare që Këshilli Kombëtar Shqiptar ndan në zbatim të ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e RKS për vitin 2025, nga organizata buxhetore "Zyra e Kryeministrit", nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës dhe Sanxhakun" me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

Për ndihmën e njëjshme financiare do të përfshihen të gjithë nxënësit shqiptarë pa asnjë prind ose vetëm me një prind që ndjekin mësimin në shkollat me mësim në gjuhën shqipe (enti parashkollorë, shkollat fillore dhe të mesme). Shuma e përkrahjes do të caktohet nga Këshilli Kombëtar Shqiptar.

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Nxënësit shqiptarë pa asnjë prind ose vetëm me një prind, që ndjekin mësimin në shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Luginë të Preshevës (enti parashkollorë, shkollat fillore dhe të mesme).

Aplikacionet duhet të dorëzohen fizikisht në ambientet e selisë së Këshillit Kombëtar Shqiptar, në Rr. Karagjorgje Petroviq nr.237, Bujanoc dhe **zyrat e Këshillit Kombëtar Shqiptar, në Preshevë, Rr, 15 Nëntori nr.90 (objekti i Shtëpisë së Kulturës), Zyra e Këshillit Kombëtar Shqiptar në Medvegjë, Rr. Vojvode Mishiq 6. më së voni ora 15:00, datë 23.04.2025.**

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në **www.kksh.org** (website i KKSH-së). Për informata shtesë ju lutem na shkruani në **kksh.grantet@gmail.com** ose na telefononi në nr. **00 381 17 853 264.**

Vërejtje: Vetëm aplikimet e dorëzuara brenda afatit dhe me dosje të plotë do të shqyrtohen.